



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:105279

Datë: 27.05.2024

Numri i dokumentit: 05737910

PAKR.nr.236/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, Departamenti i Krimeve të Rënda – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi - kryetar i kolegjit, Afërdita Bytyçi dhe Hashim Çollaku - anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Fitore Batatina, në çështjen penale kundër të akuzuarit V.S. nga Gj. Rr. "I.K.", nr., për shkak të veprave penale, Vrasje në tentativë nga neni 172 lidhur me nenin 28 të KPRK-së, e ricilësuar në veprën penale, Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 2, lidhur me paragrafin 1, të KPRK-së, veprës penale, Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 2, lidhur me paragrafin 1, dhe veprës penale, Mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 parag.1 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me ankesën e Prokurorisë Themelore në Gjilan - Departamenti i Krimeve të Rënda, e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan - Departamenti i Krimeve të Rënda, PKR.nr.105/2023, datë 23.01.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur konform dispozitës së nenit 390 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, më datë 16.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Gjilan - Departamenti i Krimeve të Rënda, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan - Departamenti i Krimeve të Rënda, PKR.nr.105/2023, datë 23.01.2024, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Gjilan - Departamenti i Krimeve të Rënda, me aktgjykimin, PKR.nr.105/2023, datë 23.01.2024, të akuzuarin V.S. e ka shpallur fajtor për dy vepra penale, Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 2, lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, dhe veprës penale, Mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 parag.1 të KPRK-së, dhe e ka gjykuar si në vijim: për veprën penale në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit më dënim me burg në kohëzgjatje prej tetë (8) muajve, për veprën penale në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar më dënim me burgim në kohëzgjatje prej nëntëdhjetë (90) ditëve, dhe për veprën penale në pikën III të dispozitivit të aktgjykimit më dënim me burgim në kohëzgjatje prej gjashtëdhjetë (60) ditëve. Më aplikimin e dispozitës së nenit 76 paragrafi 1 dhe 2, nën paragrafi 2.2 të KPRK-së, i akuzuarin V.S. është gjykuar më dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti, i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në dënimin e shqiptuar me burgim të akuzuarit i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 09.05.2023, e deri më datën 29.12.2023, si dhe masa e arrestit shtëpiak nga data 29.12.2023 e deri më datën 23.01.2024.

I akuzuari është detyruar që të paguaj shpenzimet e procedurës penale, dhe paushallin gjyqësor në shumën prej pesëdhjetë (50) Euro, si dhe shumën prej pesëdhjetë (50) Euro, në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka ushtruar:

Prokuroria Themelore në Gjilan, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe për shkak të vendimit mbi sanksionin penal, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës t'a ndryshoj aktgjykimin e ankimuar sa i përket vendimit mbi dënimin, për veprat penale si në dispozitivin II. dhe III. për të cilat të akuzuarin V.S. e ka shpall fajtor, ashtu që të akuzuarit t'i shqiptojë dënim me burgim me kohëzgjatje më të gjatë, si dhe aktgjykimin ta anuloj dhe lëndën t'ia kthej gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim, sa i përket veprës për të cilën ka bërë rikualifikimin apo të njëjtin aktgjykim ta ndryshoj, ashtu që të njëjtin t'a shpall fajtorë dhe t'i shqiptojë një sanksion penal të paraparë me Kodin Penal të Republikës së Kosovës.

Përgjigje në ankesën e Prokurorisë Themelore në Gjilan kanë paraqitur mbrojtësit e të akuzuarit V.S., av. E.H. dhe av. A.I., me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës, ankesën e Prokurorisë Themelore në Gjilan, t'a refuzoj si të pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar t'a vërtetoj.

Prokurori i Apelit me parashtrësën, PPA/I.nr.221/2024, datë 22.04.2024, ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Gjilan, aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet sa i përket veprave penale si në dispozitivin II dhe III të aktgjykimit të ankimuar dhe të akuzuarit ti shqiptohet dënim me i gjatë me burg efektiv, apo aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe çështja të kthehet në rigjykim dhe rivendosje, ndërsa përgjigjeja në ankesë e mbrojtësve të akuzuarit, av. E.H. dhe av. A.I. të refuzohet si e pabazuar.

Konform nenit 390 par.1 të KPPK-së, është caktuar dhe mbajtur seanca e kolegjit në të cilën prezantuan mbrojtësit e të akuzuarit V.S. av. E.H. dhe av. A.I. ndërsa nuk prezantuan i akuzuari V.S. dhe Prokurori i Prokurorisë së Apelit, edhe pse të njoftuar në mënyrë të rregullt gjyqësore për kohën dhe vendin e mbajtjes së seancës, andaj seanca e kolegjit u mbajt konform nenit 390 par. 4 të KPPK, në mungesë të tyre.

Mbrojtësit e të akuzuarit V.S. av. E.H. dhe av. A.I. deklaruan se mbetën në tërësi pranë përgjigjes se përbashkët të ushtruar me shkrim në ankesën e Prokurorisë Themelore në Gjilan, duke propozuar që kjo ankesë të refuzohet si e pabazuar ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit pasi që ka studiuar aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore të Prokurorisë Themelore në Gjilan – Departamenti për Krime të Rënda, përgjigjet në ankesë të PTH-së, propozimin e Prokurorisë së Apelit, dhe duke analizuar shkresat e lëndës në këtë çështje penale në vështrim të nenit 394 paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale, gjeti se:

Ankesa nuk është e bazuar.

Pretendimet ankimore të Prokurorisë

Në ankesën e Prokurorisë Themelore në Gjilan theksohet se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të parapara në nenin 384 par. 2 nënpar. 2.7 të KPPK-së, që si të tillë e bënë aktgjykimin të paqëndrueshëm juridikisht, ngase aktgjykimi është përpiluar në kundërshtim me nenin 369 të KPPK-së. Për faktin se gjykata në arsyetimin e aktgjykimit duhet të paraqet qartë dhe në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsyesh i konsideron të vërtetuara apo të pavërtetuara, duke vlerësuar saktësinë e provave kundërthënëse,

si dhe arsyet në të cilat është bazuar me rastin e mungesës së provave fakt që nuk i potencon fare, por vetëm e bënë rikualifikimin e veprës penale nga vrasje në tentative në veprën penale lëndim i lehtë trupor.

Lidhur me shkelje të ligjit penal prokurori thekson se nga provat e administruara në shqyrtim gjyqësor, shihet qartë se i akuzuari është kryes i veprës penale që i vihet në barrë, ngase me provat materiale të deponuara si dhe nga dëgjimi i të dëmtuarit dhe dëshmitarëve, nuk ka asnjë mëdyshje se i njëjti është kryerës dhe përgjegjës për veprën penale të ngarkuar në aktakuzë.

Lidhur me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike prokurori në ankesë thekson se gjykata pas mbajtjes së seancave gjyqësore dhe administrimit të provave, nuk i ka vlerësuar drejtë provat e proceduara në shqyrtimin gjyqësor prandaj edhe si pasojë e kësaj ka arritur deri tek përfundimi i gabuar i vlerësimit të gjendjes faktike meqenëse po të kishte peshuar të njëjtat në mënyrën e njëjtë nuk do ta rikualifikonte veprën penale nga vrasje në tentativë në lëndim të lehtë trupor ngase provat e shtjelluara gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe atë deklarata e të dëmtuarit M.R. i cili ka deklaruar se është e vërtetë se ditën kritike i akuzuari V. e kishte goditur me një mjet në dorë fillimisht në këmbë sa ka qenë në këmbë ndërsa goditjet tjera kanë vazhduar sa ka qenë i shtrirë në tokë, ku nga të goditurat e marra është detyruar të kërkojë ndihmë mjekësore, e të cilat lëndime janë konstatuar edhe nga ekspertiza mjeko ligjore nga e cila është konstatuar se lëndimet janë të shkaktuar nga një mjet i fortë dhe i rënd prerës dhe shpues me të cilin ka tentuar ta vras të njëjtin. Më tutje në ankesë prokurori përshkruan pjesë nga deklaratat e dëshmitarëve: L.M., A.R., A.M., duke konsideruar se nga këto dëshmi rezulton se raportet në mes të akuzuarit V.S. dhe të dëmtuarit M.R., kanë qenë të acaruar për shkak të një konflikti paraprak që kanë pas po në të njëjtën natë tek kazino në fshatin K. dhe kjo na bënë të kuptojmë qëllimin e kryesit dhe pasojat edhe pse kjo veprë penale mund të kryhet edhe me mjet të rrezikshëm, fakti se i akuzuari me dashje ka tentuar t'a vras të dëmtuarin kjo vërtetohet edhe nga deklarata e të dëmtuarit i cili natën kritike e ka parë të akuzuarin se në dorë e ka pas një mjet të mprehtë, si dhe kjo qëndron dhe kjo argumentohet me prova material siç është ekspertiza mjekësore në emër të të dëmtuarve M.R. dhe të dëmtuarit L.M. të lëshuara nga ekspertët mjeko-ligjor, ku është konstatuar se lëndimet janë të pësuar nga një mjet i fortë dhe i rënd prerës shpues, ngase se i akuzuari natën kritike ka pas në dorë thikën dhe qëllimi i tij ka qenë të vras të dëmtuarin, e gjithë kjo urrejtje ka rrjedh në shenjë të hakmarrjes të cilën e kanë pas kohë po në të njëjtën natë tek kazino në fshatin K. Për këtë arsye konsideron se aktgjykimi me të cilin gjykata ka bërë rikualifikimin e veprës penale nga vrasje në tentativë nga neni 147 i KPRK-ës, në veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 të KPRK-së, është i pa qëndrueshëm, sepse është marr si

pasojë e një vërtetimi jo të drejtë, jo të plotë dhe të gabuar i gjendjes faktike dhe si i tillë aktgjykimi është i pa drejtë, i pa argumentuar dhe pa mbështetje ligjore.

Prokurori në ankesë lidhur me vendimin mbi dënim thekson se me aktgjykimin e ankimuar të akuzuarit nuk i është shqiptuar dënimi i merituar, se dënimi i shqiptuar është në kundërshtim me rregullat e përgjithshme mbi matjen dhe caktimin e drejtë të dënimit, se gjykata ka nënvlerësuar rrethanat rënduese, sepse sikur të kishte parasysh pasojat e shkaktuara tek të dëmtuarit, mënyrën e kryerjes së veprës penale që përveç se i dhunshëm ka qenë edhe shumë përlulës për të dëmtuarit ngase përpos që e ka godit sa ka qenë i dëmtuari në këmbë të njëjtin e godet edhe sa i dëmtuari M. ka qenë i shtrirë rrethanë të cilën është dashur ta ketë parasysh, fakti se është përdorur edhe mjeti i përshtatshëm për shkaktimin e lëndimit thika, e që në rastin konkret e bën rrethanë veçanërisht rënduese, pastaj mënyrën e kryerjes së veprave penale dhe këmbëngulësinë e treguar pasi i njëjti i ka shkaktuar lëndime edhe të dëmtuarit L. dhe përkundër se i akuzuari ka kërkuar falje dhe ka shpreh pendim, këto rrethana gjykata nuk është dashur ti nënvlerëson deri në atë masë sa ta ulë dënimin. Andaj, konsideron se një dënim i tillë nuk do të kontribuoj në parandalimin e kryerjes së veprave penale, nuk shpreh gjykimin shoqëror për veprat penale, e as ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, dhe se me këtë dënim nuk do të arrihet qëllimi i shqiptimit të dënimit. Nga e cekura ka propozuar si më lartë.

Vlerësimi i Gjykatës së Apelit

Të gjeturat për pretendimet ankimore për shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale

Kolegji Penal i Gjykatës së Apelit, vlerëson se pretendimet e lartë cekura ankimore të Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjiilan, për shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nuk qëndrojnë e as që ka shkelje tjera të dispozitave të procedurës penale, për të cilat, sipas detyrës zyrtare kujdeset kjo Gjykatë, e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e aktgjykimit të ankimuar.

Kolegji gjen se aktgjykimi i ankimuar nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, ngase dispozitivi i aktgjykimi është i qartë, i kuptueshëm dhe konkret, në përputhshmëri të plotë edhe me arsyetimin dhe përpilimin e dispozitivit. Në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar, janë dhënë arsyet e duhura mbi të gjitha faktet vendimtare të kësaj çështje penale-juridike, duke vepruar konform dispozitave të nenit 370 par.6 të KPPK-së, gjykata e shkallës së parë, ka paraqitur arsyet për çdo pikë të aktgjykimit dhe atë si ato faktike dhe ato juridike, të cilat si të drejta dhe të ligjshme i aprovon edhe kjo Gjykatë.

Gjykata e shkallës së parë, vlerësimin e provave e ka bërë në pajtim me dispozitat e nenit 361 par.1 të KPPK-së, duke dhënë arsye të qarta dhe konkrete për vendin, kohën dhe mënyrën se si ka ardhur deri të kryerja e veprave penale nga i akuzuari, për të cilat vepra penale i akuzuari është shpallur fajtor dhe gjykuar si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar. Gjykata e shkallës së parë ka bërë analizën e të gjitha provave të proceduara gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe lidhur me to ka paraqitur përfundimet e veta, të cilat si të drejta, objektive, dhe të ligjshme, i aprovon edhe kjo Gjykatë, prandaj thënie të ankimore se kemi të bëjmë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale konstatohen të paqëndrueshme.

Në ankesë Prokurori thekson se aktgjykimi i ankimuar është përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par. 2 nënpar. 2.7 të KPPK-së, që si të tillë e bënë aktgjykimin të paqëndrueshëm juridikisht, ngase aktgjykimi është përpiluar në kundërshtim me nenin 369 të KPPK-së, se aktgjykimi i ankimuar përkitazi me faktet vendimtare të prezantuara në dispozitiv, përmban kundërthënie, paqartësi, në arsyetim nuk jepen arsyet përkitazi me faktet vendimtare përkatësisht arsye të cilat prezantohen janë të paqarta.

Kolegji gjen se në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar janë përshkruar veprimet e të akuzuarit V.S. dhe në arsyetim janë dhënë shpjegimet e duhura mbi veprimet e ndërmarrura nga i akuzuari në kryerjen e veprave penale për të cilat është shpall fajtor, dhe se mbi gjendjen e fakteve të provuara ka derivuar edhe përgjegjësia penale e këtij të akuzuarit. Në aktgjykim janë paraqitë në mënyrë të plotë dhe të qartë faktet të cilat kanë vërtetuar kryerjen e veprave penale nga i akuzuari për të cilat është shpallur fajtor. Në aktgjykim janë paraqitë qartë dhe në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsye gjykata i konsideron të vërtetuara, si dhe janë vlerësuar provat në mënyrë të plotë. Aktgjykimi i kundërshtuar përmban arsyet e duhura mbi të gjitha faktet relevante të kësaj çështje penale. Gjithashtu kjo Gjykatë vlerëson se pretendimet e prokurorit se aktgjykimi i ankimuar nuk përmban arsyet mbi faktet vendimtare lidhur me veprën penale, janë të pabazuara, ngase gjykata e shkallës së parë drejtë ka vërtetuar se prokuroria nuk ka arritur të dëshmojë se i akuzuari V.S. ka tentuar që t'a privoj nga jeta tani të dëmtuarin M.R. Gjykata e shkallës së parë ka bërë analizën e të gjitha provave të proceduara gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe lidhur me to ka paraqitur konkludimet e veta, të cilat si të drejta objektive, dhe të ligjshme, i aprovon edhe kjo Gjykatë.

Të gjeturat për pretendimet ankimore për vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike

Sa i përket pretendimeve ankimore përkitazi me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, kolegji penal i Gjykatës së Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë gjendjen faktike në këtë çështje penale e ka vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, për shkak se me provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar se i akuzuari V.S. ka kryer veprat penale për të cilat është shpallur fajtor.

Prokurori në ankesë pretendon se gjykata e shkallës së parë në këtë çështje penale nuk ka vërtetuar në mënyrë të drejtë gjendjen faktike pasi që nuk i ka vlerësuar drejtë provat e proceduara në shqyrtim gjyqësor, se po ti kishte peshuar drejtë provat e administruara nuk do ta rikualifikonte veprën penale nga vrasje në tentativë në lëndim të lehtë trupor, ngase nga deklarata e të dëmtuarit M.R. vërtetohet se ditën kritike i akuzuari V. e kishte goditur me një mjet të dëmtuarin M.R. fillimisht në këmbë sa ka qenë në këmbë dhe më pas e ka goditur sa i dëmtuari ka qenë i shtrirë në tokë.

Kolegji penal gjen se këto pretendime ankimore të Prokurorit nuk qëndrojnë, ngase sipas shkresave të çështjes gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë nga ana e gjykatës së shkallës së parë dhe se në këtë drejtim asnjë fakt nuk ka ngelur në mëdyshje sikur se pa të drejtë pretendohet në ankesën e ushtruar. Deri të vërtetimi i gjendjes faktike, gjykata e shkallës së parë ka ardhur pas administrimit të provave dhe atë: deklaratat e të dëmtuarve të dëgjuar në cilësi të dëshmitareve M.R. dhe L.M. deklaratat e dëshmitarëve A.R., A.M., të dhëna në shqyrtimet gjyqësore, si dhe deklarata e dëshmitarit Sh.R. CD e video incizimeve të vendit të ngjarjes, konfirmimi për aprovimin retroaktiv të kontrollit UGJK.Nr.28/23 i dt.30.01.2023, Urdhëresa UGJK. Nr.28/23 e dt.13.02.2023 për Operatorin “Vala” në Prishtinë, Raportet mjekësore në emër të dëmtuarve M.R. dhe L.M. si dhe Ekspertiza mjeko-ligjore e datës 25.05.2023. Nga këto prova gjykata e shkallës së parë gjendjen faktike në këtë çështje penale e ka vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, për shkak se me provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar se i akuzuari V.S. është kryes i dy veprave penale, Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 2 e lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, dhe veprës penale, Mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 parag.1 të KPRK-së, për të cilat është shpallur fajtor.

Pretendimet e prokurorit në ankesë se i akuzuari V.S. me dashje ka tentuar që t’u privoj nga jeta tani të dëmtuarin M.R. kolegji i gjen të pa bazuara. Kolegji pajtohet me gjetjet e gjykatës së shkallës së parë se me datë 29.01.2023, rreth orës 02:15 minuta, në dalje të fshatit D. Komuna e Gj. pas një mosmarrëveshje-zënke që kishin pas natën kritike i akuzuari më të

dëmtuarin M.R. i akuzuari me dashje dhe veprim të drejtpërdrejt, duke e përdorur thikën ka goditur të dëmtuarin M.R. tri herë edhe atë një herë në kofshën e majtë dhe dy herë në dy kërcirët e këmbëve, duke i shkaktuar të dëmtuarit lëndime të lehta trupore, dhe më këtë ka kryer veprën penale, Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 2, lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, e jo veprën penale, për të cilën po pretendon prokurori, Vrasje në tentativë nga neni 172, lidhur me nenin 28 të KPRK-së, ngase nuk është vërtetuar se qëllimi i të akuzuarit të ketë qenë privimi nga jeta i të dëmtuarit M.R.

Nga deklarimi i dëshmitarit M.R. rezulton se më datë 29.01.2023, në kohën dhe vendin e përshkruar si në pikën dispozitivin I. të aktgjykimit të ankimuar, ka marr lëndimet në trup dhe atë në kofshën e majtë dhe në këmbë nga V.S. të cilit i ka parë një mjet në dorë. Ky dëshmitar gjatë deklaratës së tij nuk ka deklaruar se qëllimi i të akuzuarit ka qenë t'a privoj nga jeta. Ka shtuar se nuk ka qenë vetvetja nga se ka qenë nën ndikimin e substancave narkotike, prandaj nuk mundë ta di saktësisht se si ka ardhur deri të rasti, megjithatë i dëmtuari gjatë të gjitha fazave të procedurës penale ka deklaruar se me të akuzuarin janë shokë, nuk i bashkëngjitem ndjekës penale dhe nuk paraqet kërkesës pasurore juridike.

Nga dëshmia e të dëmtuarit - dëshmitarit L.M. rezulton se deri të lëndimi i tij kishte ardhur nga goditja që kishte marr nga i akuzuari për shkak se ai kishte ndërhy me i ndarë të akuzuarin V. S. dhe të dëmtuarin M.R. se nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale dhe nuk kërkon kompensim të dëmit.

Nga deklaratat e dëshmitarëve të cekur si më lartë, si dhe në bazë të provave tjera të administruara, dhe atë: në bazë të deklaratës së dëshmitarit Sh.R. të dhënë në polic me dt. 31.01.2023, raportit fillestar të incidentit, 2023-CA-0125, i dt. 29.01.2023, raporti i shpejtë i datës së njëjtë, raporti i oficerëve, akt përcjellësi, raporti i hetimeve, raporti shtesë hetimor, CD-ja e video incizimeve të vendit të ngjarjes, raportet mjekësore në emër të dëmtuarit M.R., L.M., si dhe ekspertizat mjeko ligjore, të dt. 25.05.2023, është vërtetuar se në kohën dhe vendin e përshkruar si në dispozitivin I. të aktgjykimit të ankimuar, i akuzuari ka kryer veprën penale, Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, e jo veprën penale, Vrasje në tentativë nga neni 172 lidhur 28 të KPRK-së, se qëllimi i të akuzuarit nuk ka qenë që t'a privoj nga jeta të dëmtuarin M.R. se deri të shkaktimi i lëndimeve në drejtim të dëmtuarit M.R. kishte ardhur për shkak të një zënke - mosmarrëveshje të cilën e kishte pasur natën kritike i akuzuari me të dëmtuarin.

Duke pasur parasysh faktin se i akuzuari me të dëmtuarin kanë qenë shokë, e që kjo është vërtetuar edhe nga deklaratat e të dëmtuarit dhe nga mbrojtja e të akuzuarit i cili ka deklaruar se nuk ka pasur për qëllim të privoj nga jeta të dëmtuarin, dhe pavarësisht kësaj një veprim të tillë me qëllim të privimit nga jeta i akuzuari nuk e ka ndërmarrë, për çka gjykata shkallës së parë me të drejtë ka ardhur të konstatimi se tek i njëjti nuk ka ekzistuar dashja për kryerjen e veprës penale të Vrasje në tentativë nga neni 172, lidhur me nenin 28 të KPRK-së. Andaj, kolegji penal i Gjykatës së Apelit duke u bazuar në të gjitha këto që u thanë më lart, vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë ka vërtetuar gjendjen faktike, për faktin se në këtë çështje penale nuk ka mbetur pa u vërtetuar asnjë fakt vendimtar.

Të gjeturat për pretendimet ankimore lidhur me shkeljen e ligjit penal

Kolegji penal, gjen të pabazuara pretendimet e Prokurorisë se gjykata shkallës së parë ka bërë shkelje të ligjit penal, kur ka bërë ricilësimin e veprës penale nga vepra penale, Vrasje në tentativë nga neni 172, lidhur me nenin 28 të KPRK-së, në veprën penale, Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, se nga provat që janë administruar pa mëdyshje është vërtetuar se i akuzuari ka kryer veprën penale të vrasjes në tentativë.

Kolegji vlerëson se me aktgjykimin e ankimuar nuk është shkelur ligji penal siç pretendon prokurori në ankesë. Kjo për faktin se veprimet e të akuzuarit V.S. i përbëjnë të gjitha elementet subjektive dhe objektive të veprës penale, Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 2, lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, dhe veprës penale, Mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 parag.1 të KPRK-së, për të cilat është shpallur fajtor, se për këto vepra penale i njëjti është penalisht përgjegjës, si dhe nuk ekzistojnë rrethana të cilat e përjashtojnë ndjekjen penale apo përgjegjësinë penale të të akuzuarit. Kolegji vëren se nga provat e administruara nga gjykata shkallës së parë nuk është vërtetuar se i akuzuari V.S. ka tentuar që t'a privoj nga jeta tani të dëmtuarin M.R. andaj mbi bazën e kësaj gjykata shkallës së parë me të drejtë nuk e ka gjet fajtor të akuzuarin për veprën penale të vrasjes në tentativë.

Të gjeturat për vendimin mbi dënimin

Duke shqyrtuar aktgjykimin e ankimuar përkritazi me vendimin mbi dënimin, kolegji penal i Gjykatës së Apelit, gjen se pretendimet ankimore të prokurorit për dënim më të ashpër ndaj të akuzuarit ngase dënimi i shqiptuar nuk i përgjigjet rrezikshmërisë shoqërore, nuk qëndrojnë.

Gjykata e shkallës së parë me rastin e shqiptimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, duke vepruar në kuptim të nenit 69, 70, 71 dhe 72 të KPRK-së, për të akuzuarin ka pasur parasysh rrethanat lehtësuese dhe atë: se i akuzuari në të gjitha fazat e procedurës penale ka pranuar fajsinë për kryerjen e veprës penale, lëndim i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, por jo për vrasje në tentativë nga neni 172 lidhur me nenin 28 të KPRK-së, pastaj faktin se i njëjti në momentin e kryerjes së veprave penale ka qenë nën ndikimin e alkoolit, pendimin e shprehur, kërkim-faljen ndaj të dëmtuarve, faktin se me të dëmtuarin M.R. kanë qenë shokë dhe se me të dëmtuarit janë pajtuar, si dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla apo të ngjashme penale. Ndërsa, si rrethanë rënduese për të akuzuarin, gjykata ka pasur parasysh shkallën e përgjegjësisë penale, intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur, përkatësisht lëndimet e shkaktuar të dëmtuarve, si dhe rrethanat në të cilat janë kryer veprat penale. Gjykata është bindur se duke marrë parasysh rrethanat e lartpërmendura dënimi i shqiptuar të akuzuarit është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale, me mënyrën e kryerjes së veprave penale, si dhe shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit, se më këtë dënim mund të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 të KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehjen e gjykimit shoqëror për veprat penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Një vlerësim të tillë të rrethanave relevante për matjen e dënimit si të drejtë dhe të ligjshëm e pranon edhe kjo gjykatë dhe gjen se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, ndërsa rrethanat e pretenduara rënduese në ankesën e prokurorit si: intensiteti i rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur dhe rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, sipas vlerësimit të kësaj gjykate nuk janë të asaj natyre dhe nuk kanë ndikim që të akuzuarit t'i shqiptohet dënim tjetër nga ai të cilin e ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë apo që të akuzuarit t'i shqiptohen dënim më i ashpër siç pretendohet në ankesë.

Prandaj, kjo Gjykatë vlerëson se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit nga ana e gjykatës së shkallës së parë është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit si ekzekutor, dhe me intensitetin e rrezikimit apo pasojave të shkaktuara dhe se me të do të mund të parandalohet i akuzuari nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, si dhe do të parandalohen personat tjerë nga kryerja e veprave penale.

Nga arsyet e sipërcekura, e në bazë të nenit 401 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – Departamenti për Krime të Rënda
PAKR.nr.236/2024, datë 16.05.2024

Bashkëpunëtorja Profesionale

Kryetari i kolegjit

Fitore Batatina

Xhevdet Abazi

Anëtarët e kolegjit:

Afërdita Bytyçi

Hashim Çollaku